



## Me shqiptarin Enver Hoxha përballë jugosllavit Tito!

Shkruan: Kristina RASI  
Zvicër, 10 tetor 2008

(Me rastin e 100 vjetorit të Ditëlindjes së Legjendarit e të pavdekshmit dhe nacionalistit Enver HOXHA)

Shqiptari Enver HOXHA ishte organizatori dhe drejtuesi kryesor i Luftës Anti-fashiste Nacional-çlirimtare të popullit shqiptar, luftë kjo që Shqipërinë dhe popullin shqiptar e radhiti në krahun e fitimtarëve të Luftës së Dytë Botërore, të Koalicionit Anti-fashist (SHBA, Britania e Madhe dhe BRSS) të Botës.

Kam bindjen e patundur se, sikur të mos ishte Enver HOXHA, populli shqiptar dhe Shqipëria do të kishin qenë të radhitur në krahët e humbësve, Koalicionit Nazi-fashist (Romë, Berlin dhe Tokio), sepse ashtu si Legaliteti edhe Balli Kombëtar, ishin bashkëpunëtorë të pushtueseve nazi-fashistë (italian dhe gjerman) në Shqipëri, dhe dihet edhe fati i humbësve, që për mua do të ishte fatale-ndarjen e Shqipërisë midis Greqisë dhe Serbisë, sepse ashtu si Serbia edhe Greqia ishin me fitimtarët e Luftës së Dytë Botërore, me Koalicionin Anti-fashist.

Shqipëria njihet, nga histografia kombëtare dhe ajo ndërkombëtare, si vendi i vetëm në Ballkan dhe më gjerë, që u çlirua pa asnjë ndihmë të huaj, por që u çlirua vetëm e përvetëm me forcat e vetme të popullit të saj shqiptar.

Shqiptari, Enver HOXHA, menjëherë pas Luftës Anti-fashiste Nacional-çlirimtare, në Shqipëri vendosi sistemin demokratik, me ç'rast edhe zhvilloi reformat demokratike popullore, siç janë:

1. Zhdukja e analfabetizmit në Shqipëri
2. Zhdukja e malaries në Shqipëri,
3. Reforma agrare në Shqipëri
4. Emancipimin e femrës shqiptare në Shqipëri
5. Elektrifikimin e Shqipërisë
6. Bonifikimin e buqësisë në Shqipëri
7. Universitetet në Shqipëri dhe
8. Unifikimin e gjuhës shqipe dhe unifikimin e kombit shqiptar në të gjitha trojet e Shqipërisë Natyrale.

Por, mbi të gjitha, shqiptari Enver HOXHA, mbrojti dhe përkrahu Kosovën dhe trojet e saj, si dhe pa as me të voglin kompromis përkrahu të drejtën e shqiptarëve të Kosovës për Republikën e saj, si hap të parë të saj drejt ribashkimint kombëtar.

Gjithashtu, kam bindjen e patundur se, sikur shqiptari i madh Enver HOXHA të jetonte deri në v. 1990, kur edhe filloi shpërbërja e ish RSFJ-së, shqiptarët sot do të ishin të ribashkuar në një shtet të vetëm kombëtar, me emrin SHQIPËRI, dhe sot shqiptarët nuk do të kishin nevojë për ta patur organizime të tjera politike, por sot (në Shek. XXI) Shqipëria Natyrale do të ishte anëtare e rregullt dhe e fuqishme e strukturave ndërkombëtare me dinjitetin dhe identitetin kombëtar.

Prandej, ne atdhetarët shqiptarë, jashtë Shqipërisë Administrative (Shqipëria Londineze), si në të kalurën, ashtu edhe tani (kur po përkujtojmë 100 Vjetorin e Ditëlindjes së Tij), e kemi dashur, e duam dhe do ta duam birin më të madh të Kombit Shqiptar, nacionalistin Enver HOXHA, që për mua duhet edhe të shpallet Hero i Kombit Shqiptar, ashtu siç Ai (Enver HOXHA) e shpalli Gjergj Kostriotin-SKENDERBEUN, Hero Kombëtar, apo edhe siç të gjithë atdhetarët e trojeve të Shqipërisë etnike siç janë: Avdyl FRASHËRI nga Permeti, Sylejman VOKSHI nga Prizreni, Ismail QEMALI nga Vlora, Isa BOLETINI nga Mitrovica, Shote GALICA nga Drenica, Hasan PRISHTINA nga Vushtrria dhe shumë të tjerë, si nga Jugu ashtu edhe nga Veriu i Shqipërisë Etnike, i gradoi dhe i shpalli heronjë të popullit shqiptar, edhe ne atdhetarët e trojeve të Shqipërisë Natyrale dhe të diasporës shqiptare, sapo ta realizojmë ribashkimin kombëtar, të lavdishmin e të pavdekshmin Enver HOXHA duhet ta shpallim Hero Kombëtar.

**LAVDI JETËS DHE VEPRËS SË NDRITUR TË LEGJENDARIT E TË  
PAVDEKSHMIT ENVER HOXHA!**